

KONTRATA E SHITJES SE AKSIONEVE

Konkluduar ne Gdansk, me 4 Shkurt 2002 mes:

KURUM-STEEL Co. me vendndodhje ne Anibal Cad, No. 13, Gebze 41400, Kocaeli, Turqi, e regjistruar ne regjistrin tregetar te Dhomes se Tregetise Stamboll me numer 242520/190088, me poshte do te quhet 'Bleresi', i perfaqesuar nga:

1. Z. Hasmet B. Kurum President

dhe

Gdanska Stocznia 'REMONTOWA' S.A. me vendndodhje ne ul. Na Ostrowiu 1, 80-958 Gdansk, Poloni, e regjistruar ne regjistrin tregetar se Gjykates se Rrethit ne Gdansk, Departamenti i Regjistrimit te Gjykates Vendore me numer KRS 0000009191, me poshte do te quhet 'Shitesi', i perfaqesuar nga:

1. Z. Krzysztof Juchniewicz Drejtor i Tregetise & Prodhimit
2. Z. Leon Domaradzki Drejtor i Finances

me permbajtjen si me poshte:

1. Objekti i kesaj kontrate eshte transferimi i se drejtes se pronesise te 56.360 (pesedhjeteeqjashtemije e treqindegjashtedhjetje) aksioneve nominative, te cilat krijojne 59 % (pesedhjeteeqjashtemije per qind) te kapitalit themeltar ne Kantierin Detar Durres- Gdansk Sh.A. (shoqeri e perbashket), me vendndodhje ne Durres, Shqiperi, e regjistruar ne Gjykaten e Rrethit Tirane, me vendim gjykate date 26.05.1993, numer 4363, qe me poshte do te quhet 'Aksionet'.
2. Shitesi deklaroi se zoteri Aksionet sic jane pershkruar ne parag. 1, me vlere nominale prej 10.399.66 Leke Shqiptare secila, sikunder Aksionet e theksuara me siper jane paguar plotesisht. Vlera e pergjithshme nominale e Aksioneve te percaktuara me siper eshte 586.124.837.60 leke shqiptare. Zoteruesi i Aksioneve eshte i konfirmuar nga Kontrata Themeluese e Shoqerise date 25.05.1993 (Prapashtesa no.1), Statuti i Shoqerise Kantieri Detar Durres- Gdansk Sh.A. (Prapashtesa no. 2), Libri i Aksionereve (Prapashtesa no.3) dhe certifikata numer 1/98 (Prapashtesa no. 4), kopje te cilat jane te bashkangjitura. Shitesi deklaroi se Aksionet nuk jane penguar nga ndonje e drejte e paleve te treta.
3. Sipas Artikujve te Shoqerimit te Kantierit Detar Durres- Gdansk Sh.A., per shitjen e Aksioneve nevojitet nje aprovim i shkruar i Keshillit Mbikqyres te Kantierit Detar Durres- Gdansk Sh.A. ku ortaket e tjere jane titulluar te kene te drejten e parablerjes se Aksioneve. Keshilli Mbikqyres do te kerkoje aprovimin e tij brenda 3 muajve nga dita e dorezimit te nje oferte nga ortaku.
4. Shitesi transferon te drejten e pronesise te Aksioneve Bleresit me cmimin 1.500.000 USD (njemilione peseqindmije dollare). Transferta do te jete efektive pasi te jene plotesuar kushtet (kushte te papercaktuara) e meposhteme:

- a) Keshilli Mbikqyres kerkon aprovimin e shkruar te shitjes se Aksioneve
- b) Bleresi i jep Shitesit nje garanci bankare te parevokueshme per 90 % te pageses, e pershkruar ne paragrafin 7, pikat b) dhe d). Banka e cila do te leshoje garancine duhet te jete banke e klasit te pare dhe teksti i garancise duhet te dorezohet per aprovim prioritar nga Shitesi. Garancia bankare duhet te jete e parevokueshme dhe e pagueshme me kerkesen e pare te Shitesit duke informuar qe pagesa nuk eshte kryer nga Bleresi ne kohe.

Garancia do te jete e vlefshme deri ne perfundim te nje periudhe 30 ditore duke filluar qe nga data e pageses se fundit sic percaktohet ne paragrafin 7. pika d) dhe do te jete pjese integrale e kesaj kontrate.

- 5. Bleresi eshte i detyruar ti dorezoje Shitesit nje garanci bankare te parevokueshme per pjesen 10 % te pageses sic percaktohet ne paragrafin 4, psh: 150.000 USD (njeqindpesedhjetemije dollare) brenda 14 diteve nga dita e konkludimit te kesaj Kontrate. Banka e cila do te leshoje garancine duhet te jete banke e klasit te pare dhe teksti i garancise duhet te dorezohet per aprovim prioritar nga Shitesi. Garancia bankare duhet te jete e parevokueshme dhe e pagueshme me kerkesen e pare te Shitesit duke informuar qe pagesa nuk eshte kryer nga Bleresi ne kohe. Garancia do te jete e vlefshme deri ne 15.07.2002 dhe do te konsistoje si nje pjese integrale e kesaj kontrate. Shitesi eshte i detyruar te dorezoje nje kerkese per aprovim te Keshillit Mbikqyres brenda 14 diteve nga marrja e garancise bankare per 10 % te pageses, sic eshte pershkruar me siper.

- 6. Bleresi eshte i detyruar te plotesoje te gjitha kushtet e kerkuara nga ligji per te blere Aksionet para se Keshilli Mbikqyres jep pelqimin e tij.

- 7. Cmimi do te paguhet ne menyren e meposhteme:

- a) 10 % e vleres totale, 150.000 USD (njeqindpesedhjetemije dollare) brenda 7 diteve nga njoftimi me shkrim i Shitesit per Bleresin qe kushtet e permendura ne paragrafin 4, pika a) jane permbushur.
- b) 25 % e vleres totale, 375.000 USD (treqindeshtatedhjetepesemije dollare) brenda 28 diteve nga njoftimi me shkrim nga Shitesi per Bleresin qe kushtet e permendura ne paragrafin 4 pika a) jane plotesuar.
- c) 25 % e vleres totale, 375.000 USD (treqindeshtatedhjetepesemije dollare) brenda 6 muajve nga njoftimi me shkrim bga Shitesi tek Bleresi qe kushtet e permendura ne paragrafin 4 pika a) jane plotesuar.
- d) 40 % te vleres totale, 600.000 USD (gjashteqindmije dollare) brenda 12 muajve nga njoftimi me shkrim bga Shitesi tek Bleresi qe kushtet e permendura ne paragrafin 4 pika a) jane plotesuar.

Pagesa e percaktuar ne paragrafin 7, pika a) do ti rikthehet e plote nga ana e Shitesit Bleresit n.q.s. partneri shqiptar ekzekuton te drejten e tij te parablerjes per te blere Aksionet e Shitesit.

- 8. Garancia bankare e pershkruar ne paragrafin 4, pika b) do te dorezohet nga Bleresi tek Shitesi brenda 7 diteve nga dita ne te cilen Shitesi njofton Bleresin se kushtet e parashikuara ne paragrafin 4, pika a) jane plotesuar. Ne rast se garancia

e aprovuar nga Shitesi nuk i paraqitet atij para 30.06.2002, ose ne rast se shuma nuk do te jete paguar ne kohe sipas paragrafit 7, Shitesi do te gezoje te drejten ti jape fund kesaj kontrate dhe te mbaje pagesen e pershkruar ne paragrafin 7, pika a

Jo me vonë se 12.02.2002, Bleresi do ti dorezoje Shitesit permbajtjen e garancive te pershkruara ne paragrafin 4, pika b) dhe paragrafin 5 ashtu si banka qe do te leshoje garancine, per aprovimin e Shitesit.

9. Bleresi do te jape dokumentat e bashkuara te Aksioneve pas transferimit te pageses sipas paragrafit 7, pika a) Shitesit pas plotesimit te kushteve te parashikuara ne paragrafin 4.
10. Bilanci paraprak i Kantierit Detar Durres- Gdansk Sh.A. deri me daten 31.10.2001 eshte pjese integrale e kesaj kontrate dhe eshte bashkangjitur me kete kontrate (Prapashtesa no 5). Bleresi eshte i autorizuar te verifikoje te dhenat e percaktuara ne bilancin bashkangjitur dhe kjo e drejte do te ushtrohet nepermjet takimit te nje grupi personash te cilet do te jene te autorizuar te marrin pjese ne kursin e ekzaminimit te raportit financiar te vitit 2001. ne rast se vlera e detyrimeve te Kantierit Detar e treguar ne raportin financiar te vitit 2001 i kalon detyrimet e percaktuara ne bilancin bashkangjitur me vleren 20 %, Bleresi ka te drejten te terhiqet nga kjo kontrate me nje lajmerim me shkrim. E drejta per tu terhequr nga kontrata merr fund me date 15.03.2002.
11. Te gjitha kostot ne lidhje me kete Kontrate, perfshi taksat, do te paguhen ne menyren e meposhteme:
 - i. Kostot e lidhura me vendndodhjen e cdo pale do te mbulohen nga keto pale,
 - ii. Kostot ne lidhje me transferimin e Aksioneve ne Shqiperi do te mbulohen nga secila pale sipas Ligjit Shqiptar.
12. Ndryshimet e kesaj kontrate jane te pavlefshme n.q.s. nuk kryhen me shkrim.
13. Cdo mosmarveshje midis paleve par sa i perket interpretimit ose zbatimit te kesaj kontrate do te zgjidhet nga palet me mirekuptim te perbashket. N.q.s. nje mosmarveshje nuk do te zgjidhet brenda 3 muajve, duke filluar nga dita kur njera pale propozoi nje menyre per mirekuptim te perbashket, pala e interesuar mund ta coje mosmarveshjen perpara Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit ne Dhomen e Tregetise Nderkombetare ne Paris sipas rregullave te saj, bazuar ne rregullat e vlefshme arbitrare te pershtatshme te Komisionit te Kombeve te Bashkuara te Ligjit te Tregetise Nderkombetare (UNCITRAL) i cili eshte ne fuqi diten e firmosjes se Kontrates.
14. Kontrata do te drejtohet nga Legjislacioni Francez.
15. Kontrata eshte pergatitur ne dy kopje te njejta ne Anglisht, nga nje per secilen pale.
16. Kjo kontrate eshte subjekt i vlefshem per aprovimin e Bordit te Remontowa-s, cka do te thote dy firma te anetareve te Bordit sic eshte theksuar ne preambul.

SHITESI

Firma

Firma

BLERESI

Hasmet Bedii Kurumi